



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2023:150506  
Datë: 31.05.2024  
Numri i dokumentit: 05765076

C.nr.610/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditësit I.K, nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i tij i autorizuar A.M, avokat nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson Av. B.O nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit të pagave përcjellëse, vlera e kontestit 1,349.70 €, pas dhënies së përgjigjes në padi, më datë 31.05.2024, mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit I.K, nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit dhe

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të tri pagave përcjellëse mujore në lartësi të pagës mesatare në tre muajt e fundit, shumën prej 1,349.70 Euro, me kamatën ligjore 8 % në nivel vjetor e cila është duke rrjedhur që nga data 07.07.2023 (pra nga dita e ushtrimit të padisë e deri më sot), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, SI ME BAZË.

III. DETYROHET e paditura që në po të njëjtin afat, paditësit t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 135,00 €, me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

#### A r s y e t i m

Paditësi nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar me padi kësaj gjykate i ka ushtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të pagave në emër të pensionimit, në shumën e përgjithshme prej 1,349.70 €.

E paditura duke vepruar sipas aktvendimit të gjykatës më dt.14.08.2023, ka dorëzuar në gjykatë përgjigjen në padi me anë të së cilës e ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit me arsyetim se e paditura e konteston padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, ngase konsideron se padia si e tillë është e pa themeltë dhe e pabazuar ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit. Gjithashtu, padia e paditësit nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën është thirrur pala paditëse, rezulton se është parashkruar në tërësi. Paditësi ka ushtruar padi në gjykatë më 07.07.2023, me të cilën ka kërkuar

kompensim të tri pagave përcjellëse përtej vlefshmërisë së Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2021. Me njoftim për shkëputje të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021, MASHTI ka shkëputur këtë kontratë më 21.11.2022 me SBASHK. MASHTI me këtë rast ka theksuar se shkëput kontratën njëanshme bazuar në kornizën ligjore në fuqi, pasi që e njëjta është nënshkruar në mungesë të bazës ligjore, shpërputhje me dispozitat e rendit publik dhe mungesës së legjitimitetit të palës nënshkruese. Më tej MASHTI me këtë veprim është bazuar në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin K072/20 pasi që Ministrisë së Arsimit në kohën e nënshkrimit të Kontratës Kolektive, i mungonte autoriteti kushtetues për të ushtuar kompetencat përkatëse. MASHTI me këtë rast ka numëruar një sërë shkeljesh të tjera ligjore me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate. Më tej, Gjykata Supreme ka nxjerrë Mendimin juridik më 27.02.2023 për zbatimin e pagesës së shpërblimit jubilar dhe vlefshmërisë së Kontratës Kolektive Parauniversitare të vitit 2014; të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të vitit 2015; të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të vitit 2016 dhe të Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2017, por nuk e ka shqyrtuar Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata i ka zbatuar provat duke bërë shikimin në vendimin për përfundimin e marrëdhënies së punës nr. i prot. 406 të datës 02.08.2022, si dhe listat e pagës 01.05.2022.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka pasur të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësi për periudhën e kërkuar kohore ka prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësit pagesa e tre pagave me rastin e pensionimit.

Me administrimin e vendimin për përfundimin e marrëdhënies së punës nr. i prot. 406 të datës 02.08.2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësit I.K i ka përfunduar marrëdhënia e punës me datë 10.08.2022, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Me administrimin e listave të pagave për muajin Maj, Qershor, Korrik 2022 për paditësin, gjykata vërtetoi faktin se paditësi I.K në këtë periudhë kishte në shumën prej 499.90 euro.

Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqjësë dhe gjendjen faktike të vërtetuar, se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që e detyroi të paditurën që paditësit t'ia shpërblejë tri pagat me rastin e pensionimit në shumën prej 1,349.70 Euro.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditësit është dorëzuar më datën 07.07.2023, ndërsa paditësit i ka përfunduar marrëdhënia e punës me datë 10.08.2022, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit*

prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (16.04.2020), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Sipas dispozitës së nenit 35.9 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017, është paraparë se: *“Punëtorët që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri (3) pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenit 449, 452 dhe 453.1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësit t’ia kompensojë edhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 135,00 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë 104,00 € dhe në emër të taksës për padi 31,00 € bazuar në tarifën e OAK-së.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
C.nr.610/2023, më 31.05.2024

B. Profesional  
Armond Omega

Gjyqtari  
Betim Behluli

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit – Divizioni Civil në Prishtinë.